

UDHËZIM
Nr. 9, datë 3.12.2024

**PËR NJË ZHVILLIM TË HARMONIZUAR ME RRJETET TRANSEVROPIANE NË
FUSHËN E INFRASTRUKTURAVE TË TELEKOMUNIKACIONIT DHE
ZHVILLIMIN E PIKAVE TË AKSESIT TË LIDHJEVE LOKALE *WiFi*¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 5, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 434 datë 3.6.2020, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020–2025”,

UDHËZOJ:

Neni 1
Qëllimi i udhëzimit

1. Ky udhëzim ka si qëllim:

a) përcaktimin e projekteve me interes të përbashkët në fushën e rrjeteve transevropiane në fushën e infrastrukturës së telekomunikacionit në harmoni me rregulloren e Bashkimit Evropian për CEF-in²;

b) përcaktimin e objektivave dhe prioriteteve operacionale të projekteve me interes të përbashkët, identifikimin e projekteve me interes të përbashkët dhe kriteret sipas të cilave veprimet që kontribuojnë në projektet me interes të përbashkët që janë të pranueshme për asistencë financiare të BE-së në përputhje me rregulloren e CEF-it të BE-së në lidhje me zhvillimin e tyre, zbatimin, vendosjen, ndërlidhjen dhe ndërveprueshmërinë;

c) përcaktimin e kërkesave që duhet të përmbushen në ofrimin e lidhjes internet në komunitet lokale *WiFi*.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Përcaktimet e këtij udhëzimi janë të zbatueshme në projekte të interesit të përgjithshëm të rrjeteve transevropiane në fushën e infrastrukturave të telekomunikacionit dhe që janë të pranueshme për financim sipas CEF-it, si dhe për projekte rajonale dhe/ose kombëtare që vijnë në plotësim dhe të harmonizuar me këto rregulla për projekte të interesit të përbashkët.

Neni 3
Përkufizimet

1. Për qëllime të këtij udhëzimi në lidhje me rrjetet transevropiane të telekomunikacionit termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Infrastrukturë e telekomunikacionit” nënkupton rrjetet *broadband* dhe infrastrukturat e shërbimeve digjitale;

¹ Ky udhëzim është i përafëruar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 283/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014, mbi udhëzimet për rrjetet transevropiane në fushën e infrastrukturave të telekomunikacionit që shfuqizon vendimin e BE-së nr. 1336/97/KE, të ndryshuar me rregulloren (BE) 2017/1953 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2017, që ndryshon Rregulloret (BE) nr. 1316/2013 dhe (BE) nr. 283/2014 në lidhje me promovimin e lidhjes së internetit në komunitetet lokale.

² Rregullorja (BE) nr. 1316/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 dhjetor 2013, për krijimin e Facilitetit Evropian të Konektivitetit (CEF), që amendon rregulloren e BE-së nr. 913/2010 dhe shfuqizon rregulloren e BE-së nr. 680/2007 dhe rregulloren nr. 67/2010.

b) “Infrastrukturë e shërbimit digjital” nënkupton infrastrukturat të cilat mundësojnë ofrimin në mënyrë elektronike të shërbimeve të rrjetit, zakonisht nëpërmjet internetit, duke ofruar shërbime të ndërveprueshme transevropiane me interes të përbashkët për qytetarët, bizneset dhe/ose autoritetet publike, dhe që përbëhen nga platformat e shërbimeve kryesore dhe shërbimeve të përgjithshme;

c) “Bllloqe ndërtuese” nënkupton infrastrukturat e shërbimit digjital bazë, të cilat janë mundësuesit kryesor të ripërdorimit në infrastrukturat e shërbimeve digjitale më komplekse;

d) “Platformat e shërbimit bazë” nënkupton “*hub-et*” qendrore të infrastrukturës së shërbimeve digjitale që synojnë të sigurojnë lidhjet transevropiane, aksesin dhe ndërveprueshmërinë, dhe që janë të hapura për Shtetet Anëtare të BE-së dhe mund të jetë e hapura për subjekte të tjera;

e) “Shërbime të përgjithshme” nënkupton shërbimet “*gateway*” që lidhin një ose më shumë infrastruktura kombëtare në platformat të shërbimit kryesor;

f) “Rrjete me brez të gjerë” nënkupton rrjetet me akses me tela dhe pa tel, infrastrukturën ndihmëse dhe rrjetet bazë të afta për të ofruar lidhje me shpejtësi shumë të lartë;

g) “Veprime horizontale” nënkupton studime dhe veprimet mbështetëse programore të përcaktuara në rregulloren përkatëse të BE-së për krijimin e programit CEF.

h) “Pika e aksesit lokal pa tel” nënkupton pajisje me fuqi të ulët dhe të përmasave të vogla që operojnë brenda një rrezeje të vogël, me radio frekuenca me bazë joekskluzive dhe në kushtet e disponueshmërisë dhe përdorimit eficient të harmonizuara në nivel evropian që i mundëson përdoruesit aksesin pa tel në një rrjet të komunikimit elektronik.

Neni 4

Objektivat e përgjithshëm dhe prioritetet operationale

1. Objektivat e përgjithshme për projektet me interes të përbashkët transevropiane përcaktohen në nenin 3, të rregullores (BE) për krijimin e CEF. Projektet me interes të përbashkët transevropiane përmbushin një ose më shumë nga objektivat specifike të mëposhtme:

a) kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe mbështesin kompletimin dhe funksionimin e tregut të brendshëm bazuar në rritje të konkurrencës së ekonomisë evropiane, duke përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM);

b) kontribuojnë në përmirësimin e jetës e përditshme për qytetarët, bizneset dhe autoritetet publike në çdo nivel nëpërmjet promovimit të rrjeteve me brez të gjerë, ndërlidhjes dhe ndërveprueshmërisë me rrjetet kombëtare, rajonale dhe lokale me brez të gjerë, si dhe akses jodiskriminues në rrjete të tilla dhe përfshirjen digjitale.

2. Prioritetet operationale që kontribuojnë në arritjen e objektivave të përmendura në paragrafin 1, janë si më poshtë:

a) ndërveprueshmëria, lidhja, vendosja e qëndrueshme, funksionimi dhe përmirësimi i infrastrukturave të shërbimit digjital transevropian, si dhe koordinimi në nivel evropian;

b) fluksi efikas i investimeve private dhe publike për të stimuluar vendosjen dhe modernizimin e rrjeteve me brez të gjerë me synimin për të kontribuar në arritjen e objektivave të Agjendës Digjitale për Evropën për rrjetet me brez të gjerë.

Neni 5

Projektet me interes të përbashkët transevropian

1. Projektet me interes të përbashkët në rrjetet transevropiane, në veçanti, duhet:

a) të synojnë krijimin dhe/ose përmirësimin e ndërveprueshmërisë dhe, kurdoherë që është e mundur, platformat e shërbimit qendror ndërkombëtar, të shoqëruara me shërbime të përgjithshme për infrastrukturat e shërbimit digjital;

b) të sigurojnë mjete investimi efikase për rrjetet me brez të gjerë, të tërheqin kategori të reja investitorësh dhe promovuesish projektesh dhe të inkurajojnë rikrijimin e projekteve të inovacionit dhe modeleve të biznesit.

c) të mbështesin ofrimin e lidhjes lokale pa tel me cilësi të lartë që është pa pagesë dhe pa kushte diskriminuese në komunitetet lokale;

2. Projektet me interes të përbashkët mund të përfshijnë tërësinë e ciklit e tyre, përfshirë studimet e fizibilitetit, zbatimin, funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm, koordinimin dhe vlerësimin.

3. Projektet me interes të përbashkët mund të mbështeten nëpërmjet veprimeve horizontale sipas përcaktimeve në rregulloren e BE-së për CEF-in.

4. Projektet me interes të përbashkët në fushën e infrastrukturave të telekomunikacionit dhe aktivitetet që kontribuojnë për to, përshkruhen në Aneksin bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 6

Metodat e ndërhyrjes

1. Bazuar në praktikën e BE-së, investimet në rrjetet me brez të gjerë do të ndërmerren kryesisht nga sektori privat, i mbështetur nga një sektor konkurrues dhe në një kuadër rregullator miqësor për investime. Mbështetja publike për rrjetet me brez të gjerë do të sigurohet vetëm kur ka dështim tregu ose në një situatë ku investimi është nën optimalen.

2. Në rastet e zbatueshme, të pjesëmarrjes në projekte të interesit të përbashkët sipas CEF-in, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë brenda fushës së vet të përgjegjësisë, si dhe subjektet e tjera përgjegjëse për kontributet në zbatimin e projekteve të përbashkëta ku mund të merret pjesë, do të punojnë për të nxitur interesin për të marrë masat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e projekteve me interes të përbashkët.

3. Veprimet që kontribuojnë në projektet me interes të përbashkët, janë ato që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 7 të këtij udhëzimi, dhe që kualifikohen për ndihmë financiare të Bashkimit sipas kushteve dhe instrumenteve të disponueshme sipas rregullores së BE-së për CEF-in. Në rast aplikimi ndihma financiare ofrohet në përputhje me rregullat dhe procedurat përkatëse të miratuara nga Bashkimi Evropian, prioritetet e financimit të përcaktuara në nenin 7 të këtij udhëzimi dhe disponueshmërisë së burimeve, duke marrë parasysh nevojat e veçanta të përfutësve.

4. Veprimet që kontribuojnë në projekte me interes të përbashkët në fushat e rrjeteve me brez të gjerë do të mbështeten nga:

a) instrumentet financiare siç përcaktohet në rregulloren e BE-së për CEF-in, i cili do të jetë i hapur për kontribute shtesë nga sektorë të tjerë të CEF-it, instrumente të tjera, programet dhe linjat buxhetore në buxhetin e Bashkimit, Shtetet Anëtare, duke përfshirë autoritetet rajonale dhe lokale dhe çdo investitor tjetër, përfshirë investitorët privatë në përputhje me rregulloren e BE-së për CEF, dhe/ose,

b) kombinimin e instrumenteve financiare dhe granteve nga burime publike të ndryshme nga CEF, pavarësisht nëse janë publike burimet e Bashkimit ose burimet kombëtare.

5. Veprimet që kontribuojnë në projekte me interes të përbashkët në fushën e ofrimit të lidhjes lokale pa tel që është pa pagesë dhe pa kushte diskriminuese në komunitetet lokale do të mbështeten nga:

a) grantet; dhe/ose

b) forma të tjera të ndihmës financiare, pa përfshirë instrumentet financiare;

6. Veprimet horizontale do të mbështeten nga prokurimi; dhe/ose grantet.

7. Rregullorja e BE-së për CEF-in përcakton buxhetin e disponueshëm dhe kriteret për mbështetje të rrjeteve të infrastrukturave dhe kërkesa të tjera të performancës që duhen përmbushur.

Kriteret e pranueshmërisë dhe prioritetet për financim

1. Veprimet që kontribuojnë në projekte me interes të përbashkët në fushën e infrastrukturave të shërbimit digjital do të plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme për t'u kualifikuar për financim nga CEF-i:

- a) kanë aftësi të mjaftueshme për t'u zhvilluar, siç vërtetohet veçanërisht përmes pilotimit të suksesshëm të programeve, siç janë programet e Bashkimit që lidhen me inovacionin dhe kërkimet;
- b) të kontribuojë në politikat dhe aktivitetet e Bashkimit në mbështetje të tregut të brendshëm;
- c) të krijojë vlerën e shtuar evropiane dhe të ketë një strategji dhe planifikueshëri për qëndrueshmëri afatgjatë, aty ku është e përshtatshme përmes burimeve të financimit të ndryshme nga CEF-i, cilësia e së cilës duhet të demonstrohet nga një vlerësim i fizibilitetit dhe përfitimit të kostos. Një strategji e tillë do të përditësohet kur të shihet e përshtatshme;
- ç) të përputhen me standardet ndërkombëtare dhe/ose evropiane ose specifikimet dhe orientimet e hapura për ndërveprim të tilla si Korniza Evropiane e Ndërveprueshmërisë dhe kapitalizimi në zgjidhjet ekzistuese.

2. Përzgjedhja e veprimeve që kontribuojnë në projektet me interes të përbashkët në fushën e infrastrukturave të shërbimeve digjitale që do të financohen nga CEF-i, si dhe nga niveli i tyre i financimit, duhet të kryhet si pjesë e një programi vjetor pune sipas rregullores së BE-së për CEF-in.

3. Blloqeve ndërtuese thelbësore, perspektivat të demonstrueshme për t'u përdorur në zhvillimin, vendosjen dhe funksionimin e infrastrukturave të tjera të shërbimeve digjitale të listuara në Seksionit 1.1 të Aneksit, do t'i jepet përparësia kryesore për financimin.

4. Prioriteti i dytë do t'u jepet infrastrukturave të tjera të shërbimit digjital në mbështetje të ligjit, politikave dhe programeve të Bashkimit, si të listuara në seksionet 1.2 dhe 1.3 të shtojcës dhe, kur është e mundur, të bazohet në blloqet ekzistuese të ndërtuese.

5. Mbështetja për platformat kryesore të shërbimit do të kenë përparësi shërbimet e përgjithshme.

6. Mbi bazën e objektivave të parashikuara në nenin 3 të kësaj rregullore, përshkrimin e projekteve me interes të përbashkët në aneksin e kësaj rregulloreje dhe, duke marrë parasysh buxhetin në dispozicion, programet vjetore dhe shumëvjeçare të punës referuar në nenin 17 të rregullores së BE-së për CEF-in mund vendosin kritere të mëtejshme të përshtatshmërisë dhe përparësisë në fushën e infrastrukturave në shërbimin digjital.

7. Veprimet që kontribuojnë në projekte me interes të përbashkët në fushat e rrjeteve *broadband* duhet të plotësojnë të gjitha kriteret sa vijon për t'u kualifikuar për financim:

- a) të japin një kontribut të rëndësishëm në realizimin e objektivave të Agjendës Digjitale për Evropën;
- b) të jenë në nivel të mirë maturimi të zhvillimit dhe përgatitjes së projektit që mbështeten nga mekanizma efektivë të zbatimit;
- c) të adresojë dështimet e tregut ose situatat e investimeve jooptimale;
- ç) të mos çojë në shtrembërime të tregut ose në largimin jashtë të investimeve private;
- d) të përdorë teknologjinë që konsiderohet më e përshtatshme për të adresuar nevojat e zonës gjeografike në fjalë, duke marrë parasysh gjeografinë, faktorët sociale dhe ekonomike të bazuar në kritere objektive dhe në përputhje me neutralitetin teknologjik;
- dh) të vendosë teknologjinë më të përshtatshme për projektin specifik, duke propozuar ekuilibrin më të mirë midis teknologjive më të mira për sa i përket kapacitetit të rrjedhës së të dhënave, siguria e transmetimit, qëndrueshmëria e rrjetit dhe efikasiteti i kostos;
- e) të ketë një potencial të lartë për përsëritje dhe/ose të bazohet në modele inovative biznesi.

8. Veprimet që kontribuojnë në projekte me interes të përbashkët në fushën e ofrimit të lidhjes lokale pa tel me cilësi të lartë, që është pa pagesë dhe pa kushte diskriminuese në komunitetet lokale duhet të plotësojë kushtet të përcaktuara në seksionin 4 të Aneksit, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

9. Veprimet horizontale duhet të plotësojnë një nga kriteret e mëposhtme, për t'u kualifikuar për financim:

- a) të përgatisë ose mbështesë veprimet e zbatimit në zhvillimin e tyre, qeverisjen dhe të adresojnë problemet e ekzistuese ose në zhvillim të zbatimit; ose
- b) të krijojnë kërkesë të re për infrastrukturën e shërbimit digjital.

Neni 8

Bashkëpunimi me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare

1. Me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes në projekte të interesit të përbashkët për rrjetet transevropiane në fushën e infrastrukturave të telekomunikacionit, por jo vetëm, të pranueshme për financim sipas CEF-it, do të punohet për vendosjen e kontakteve, diskutohet dhe do të shkëmbehen informacione, si dhe do të bashkëpunohet me autoritetet publike ose ndonjë tjetër organizatë në vendet e Bashkimit Evropian dhe të rajonit.

2. Ky bashkëpunim do të përpiqet të promovojë ndërveprueshmërinë ndërmjet rrjeteve në fushën e infrastrukturës së telekomunikacionit me Bashkimin Evropian dhe rrjete të ngjashme në vendet e tjera në rajon, si dhe në krijimin e sinergjive në rrjetet transevropiane të konektivitetit që i shërbejnë objektivave të përgjithshëm dhe integritetit në Bashkimin Evropian.

3. Në lidhje me projektin WiFi do të bashkëpunohet me institucionet/subjektet përgjegjëse dhe GIZ për zbatimin e projektit rajonal për transformimin digjital të Ballkanit Perëndimor me qëllim harmonizimi dhe koordinimi për maksimizimin e përfitimit dhe rritjen e numrit total të pikave të aksesit lokal pa tel në të gjithë vendin duke shmangur dublikimet.

Neni 9

Shkëmbim informacioni, monitorim dhe raportim

Për aq sa është e zbatueshme në rastin e pjesëmarrjes në projektet e interesit të përbashkët në rrjetet transevropiane sipas CEF-it, ministria përgjegjëse për infrastrukturën transevropiane do të shkëmbejë informacion me Komisionin Evropian dhe/ose strukturat e tjera përgjegjëse për zbatimin e rregullores së CEF-it në lidhje me progresin e projekteve të interesit të përbashkët ku merret apo kërkohet të merret pjesë sipas rastit dhe për aq sa është relevante.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

ANEKS

PROJEKTET E INTERESIT TË PËRBASHKËT

Bazuar në udhëzimin e BE-së për rrjetet transevropiane në fushën e infrastrukturave të telekomunikacionit³, projektet e interesit të përbashkët përfshijnë:

1. Infrastrukturën e shërbimit digjital;

³ Rregullorja e (BE) nr. 283/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014, mbi udhëzimet për rrjetet transevropiane në fushën e infrastrukturave të telekomunikacionit që shfuqizon vendimin e BE-së nr. 1336/97/KE, të ndryshuar me rregulloren (BE) 2017/1953 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2017, që ndryshon rregulloret (BE) nr. 1316/2013 dhe (BE) nr. 283/2014 në lidhje me promovimin e lidhjes së internetit në komunitetet lokale

2. Rrjetet *broadband*;
3. Veprimet horizontale;
4. Lidhjet pa tel në komunitetet lokale (WiFi);

SEKSIONI 1. INFRASTRUKTURAT E SHËRBIMIT DIGJITAL

Ndërhyrjet në fushën e infrastrukturës së shërbimit digjital në përgjithësi mbështeten në një qasje të arkitekturës me dy shtresa:

- a) platforma bazë e shërbimit; dhe
- b) shërbimet e përgjithshme.

Platforma bazë e shërbimit janë parakusht për krijimin e një infrastrukture shërbimi digjital. Platformat kryesore të shërbimit adresojnë nevojat e ndërveprimit dhe sigurisë të projekteve me interes të përbashkët. Ato synojnë të mundësojnë ndërveprime digjitale ndërmjet autoriteteve publike dhe qytetarëve, ndërmjet autoriteteve publike dhe bizneseve dhe organizatave, ose ndërmjet autoriteteve publike të Shteteve Anëtare të ndryshme nëpërmjet platformave të ndërveprimit të standardizuara, ndërkufitare dhe miqësore për përdoruesit.

Ndërtimi i blloqeve të infrastrukturës të shërbimit digjital kanë përparësi ndaj infrastrukturave të tjera të shërbimit digjital, pasi të parat janë parakusht për këtë të fundit. Shërbimet e përgjithshme ofrojnë lidhjen me platformat kryesore të shërbimit dhe mundësojnë shërbimet kombëtare me vlerë të shtuar të përdorin platformat kryesore të shërbimit. Ato ofrojnë porta ndërmjet shërbimeve kombëtare dhe platformave bazë të shërbimit dhe lejojnë autoritetet kombëtare publike dhe organizatat, bizneset dhe/ose qytetarët të kenë akses në platformën bazë të shërbimit për transaksionet e tyre ndërkufitare. Duhet të sigurohet cilësia e shërbimeve dhe mbështetja për palët e përfshira në transaksionet ndërkufitare. Ata duhet të mbështesin dhe stimulojnë përdorimin e platformave kryesore të shërbimit

Fokusi nuk duhet të jetë tërësisht në krijimin e infrastrukturës së shërbimeve digjitale dhe shërbimeve të lidhura me to, por edhe në qeverisjen në lidhje me funksionimin e platformave të tilla.

Platformat e reja bazë të shërbimit duhet të bazohen kryesisht në platformat ekzistuese dhe blloqet e tyre ndërtuese dhe/ose, kur është e mundur, duhet të shtojnë blloqe të reja ndërtuese.

1. Blloqet ndërtuese të identifikuara për t'u përfshirë në programet e punës sipas BE-së, janë në vijim:

- a) identifikimi elektronik dhe konfirmimi: kjo u referohet shërbimeve që bëjnë të mundur njohjen ndërkufitare dhe validimin e identifikimit dhe të nënshkrimit elektronik;
- b) dorëzimi elektronik i dokumenteve: kjo u referohet shërbimeve për transmetimin e sigurt dhe të gjurmueshëm ndërkufitar të dokumenteve elektronike;
- c) përkthim i automatizuar: kjo u referohet pajisjeve të përkthimit dhe burimeve të specializuara gjuhësore, duke përfshirë këtu mjetet e nevojshme dhe ndërfaqet programuese të nevojshme për të operuar shërbimet digjitale panevropiane në një mjedis shumëgjuhësh;
- d) mbështetja kritike e infrastrukturës digjitale: kjo u referohet kanaleve dhe platformave të komunikimit që synojnë të përmirësojnë aftësitë në mbarë Bashkimin për gatishmëri, shkëmbim informacioni, koordinim dhe përgjigje ndaj kërcënimeve kibernetike;
- e) faturimi elektronik: kjo u referohet shërbimeve që mundësojnë shkëmbim të sigurt elektronik të faturave.

2. Infrastruktura të mirëkrijuara të shërbimit digjital, veçanërisht të identifikuara si të pranueshme për financim që kontribuojnë në shërbimin e pandërprerë subjekt i nenit 7(1):

- a) Akses në burimet digjitale të trashëgimisë evropiane. Kjo i referohet platformës bazë të shërbimit bazuar në Portalin aktual Evropian. Platforma ofron pikën e aksesin në përmbajtjen e trashëgimisë kulturore Europeana në nivel artikulli, një grup e specifikimeve të ndërfaqes për të bashkëvepruar me infrastrukturën (kërkimi për të dhëna, shkarkimi i të dhënave), mbështetje për përshtatjen e metadatave dhe pranimi i përmbajtjes së re, si dhe informacioni mbi kushtet për ripërdorimin e përmbajtjes të aksesueshme përmes infrastrukturës.

b) Infrastrukturë më të sigurt të shërbimit të internetit. Kjo i referohet platformës për përvetësimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e përbashkët të objekteve kompjuterike, bazat e të dhënave, mjetet softuerike dhe shkëmbimi i praktikave më të mira për Qendrat e Internetit të Sigurt (SIC) të shteteve anëtare. Operacionet e *back-office* për të trajtuar raportimin e përmbajtjes së abuzimit seksual të fëmijëve në internet janë përfshirë gjithashtu, si dhe lidhjen me autoritetet policore duke përfshirë organizatat ndërkombëtare si Interpoli, dhe kur është e përshtatshme, trajtimi i heqjes së kësaj përmbajtje nga faqet përkatëse të internetit. Kjo do të mbështetet nga bazat e të dhënave të përbashkëta dhe nga sistemet e zakonshme softuerike. SIC-i dhe aktivitetet e tyre përkatëse si linjat për ndihmë, linjat direkte telefonike, nyjat e ndërgjegjësimit dhe aktivitetet e tjera ndërgjegjëse përfaqësojnë elementin kryesor të infrastrukturës së internetit më të sigurt.

3. Infrastruktura të tjera të shërbimit digjital të identifikuar si të pranueshme për financim që i nënshtrohen nenit 7(1):

a) Shërbime të ndërveprueshme të prokurimit elektronik ndërkufitar. Kjo i referohet një grupi shërbimesh që mund të përdoren nga ofruesit e shërbimeve të prokurimit elektronik të sektorit publik dhe privat për të ngritur platforma të prokurimit elektronik ndërkufitar. Kjo infrastrukturë do t'i mundësojë çdo kompanie në Bashkim t'i përgjigjet procedurave të prokurimit publik nga ndonjë autoritet ose subjekt kontraktor në çdo Shtet Anëtar që mbulon prokurimin elektronik para dhe pas dhënies së kontratave të aktiviteteve, duke përfshirë funksionalitete të tilla si dorëzimi elektronik i ofertave, dosja e kompanisë virtuale, e-katalogët, porositë elektronike dhe faturimi elektronik.

b) Shërbime të ndërveprueshme ndërkufitare të e-shëndetit. Kjo i referohet një platforme, e cila mundëson ndërveprim ndërmjet qytetar/pacient dhe ofruesit të kujdesit shëndetësor, transmetimi nga institucion në institucion dhe nga organizata në organizatë të të dhënave, apo komunikimit *peer-to-peer* ndërmjet qytetarëve/pacientëve dhe/ose profesionistëve të shëndetit dhe institucioneve. Shërbimet do të përfshijnë aksesin ndërkufitar në të dhënat elektronike shëndetësore dhe shërbimet e recetës elektronike si tele-shërbime për shëndetin/jetesën në distancë etj.

c) Platforma Evropiane për ndërlidhjen e regjistrave evropianë të bizneseve. Kjo i referohet një platforme që ofron një grup mjetesh dhe shërbimesh qendrore që mundësojnë që regjistrat e biznesit në të gjitha Shtetet Anëtare të shkëmbejnë informacion mbi bizneset e regjistruara, degët e tyre, shkrirjet dhe mbylljet. Ai, gjithashtu, do të ofrojë një shërbim kërkimi shumëvendësh dhe shumëgjuhësh për përdoruesit që përdorin një pikë qendrore aksesit të aksesueshme nëpërmjet portalit e-Justice.

d) Akses në sektorin e informacionit publik të ripërdorshëm. Kjo i referohet një platforme për një pikë të vetme aksesit në shumë gjuhë (gjuhët zyrtare të institucioneve të Bashkimit) grupet e të dhënave të mbajtura nga organet publike në Bashkimin Evropian, nivelet kombëtare, rajonale dhe lokale; mjetet e kërkimit dhe vizualizimit të grupeve të të dhënave; sigurisë se grupet e të dhënave janë anonimizuar siç duhet, të licencuara dhe, sipas rastit, me çmim për t'u publikuar, rishpërndarë dhe ripërdorur, duke përfshirë një gjurmë auditimi të origjinës së të dhënave.

Procedurat elektronike për ngritjen dhe drejtimin e një biznesi në një vend tjetër evropian. Ky shërbim do të lejojë të gjitha procedurat e nevojshme administrative që do të trajtohen në mënyrë elektronike përtej kufijve përmes pikave të vetme të kontaktit sipas legjislacionit evropian për shërbimet.⁴

e) Shërbime të ndërveprueshme ndërkufitare *online*. Kjo u referohet platformave të cilat do të lehtësojnë ndërveprueshmërinë dhe bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare në fushat me interes të përbashkët, veçanërisht me synimin për të përmirësuar funksionimin e tregut të brendshëm, siç është drejtësia elektronike, e cila do të mundësojë aksesin ndërkufitar *online* të qytetarëve, bizneseve, organizatave dhe praktikantëve ligjorë ndaj burimeve/dokumenteve ligjore dhe procedurave gjyqësore, Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve Online (ODR), e cila do të mundësojë zgjidhjen *online* të mosmarrëveshjeve ndërkufitare ndërmjet konsumatorëve dhe tregtarëve dhe

⁴ Direktiva 2006/123/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 12 dhjetor 2006, mbi shërbimet në tregun e brendshëm (OJ L 376, 27.12.2006, f.36).

Shkëmbimi Elektronik i Informacionit të Sigurimeve Shoqërore (EESSI), i cili do të ndihmojë organet e sigurimeve shoqërore në të gjithë Bashkimin të shkëmbejnë informacione më shpejt dhe më të sigurt.

SEKSIONI 2. RRJETET BROADBAND

1. Qëllimi i veprimeve

Veprimet do të konsistojnë në veçanti nga një ose më shumë nga komponentët e mëposhtëm:

a) vendosjen e infrastrukturës fizike pasive, infrastrukturës fizike aktive ose kombinimin e të dyjave dhe elementet ndihmëse të infrastrukturës, të kompletuara me shërbimet e nevojshme për të operuar një infrastrukturë e tillë;

b) objektet shoqëruese dhe shërbimet shoqëruese, të tilla si instalimet elektrike të ndërtesave, antenat, kullat dhe konstruksione të tjera mbështetëse, kanale, përçues, direk, puseta dhe kabinete;

c) aty ku është e mundur, do të shfrytëzohen sinergjitë e mundshme ndërmjet hapjes së rrjeteve me brez të gjerë dhe të shërbimeve të tjera komunale (energji, transporti, uji, kanalizimi etj.), veçanërisht ato që lidhen me shpërndarjen inteligjente të energjinë elektrike .

2. Kontributi në arritjen e objektivave të Agjendës Digjitale për Evropën dhe objektivave kombëtare për zhvillimin e *broadband*-it:

Të gjitha projektet që marrin ndihmë financiare sipas këtij seksioni do të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në arritjen e objektivave të Agjendës Digjitale për Evropën dhe objektivave kombëtare për zhvillimin e *broadband*-it.

Veprimet e financuara drejtpërdrejt nga Bashkimi, do të:

a) të bazohet në teknologjinë me tel ose me valë të aftë për të ofruar shërbime me brez të gjerë me shpejtësi shumë të lartë, duke përmblusur kështu kërkesat për aplikacione që kërkojnë gjerësi brezi të lartë;

b) të bazohet në modele inovative biznesi dhe/ose të tërheqë kategori të reja promovuesve të projekteve ose kategori të reja investitorësh ;

c) kanë një potencial të lartë për ripërsëritshmëri, duke i lejuar kështu ata të arrijnë ndikim më të gjerë në treg për shkak të efektit demonstrues;

d) të ndihmojë në ngushtimin e ndarjes digjitale, aty ku është e mundur;

e) të jetë në përputhje me ligjin në fuqi, veçanërisht me ligjin e konkurrencës, dhe me detyrimet e aksesit në përputhje me ligjin për komunikimet elektronike.

Veprimet e financuara nga kontributet e mbikëqyrura të ofruara në përputhje me rregulloren e BE-së për CEF-it, do të sjellë aftësi të reja të rëndësishme në treg për sa i përket disponueshmërisë së shërbimit me brez të gjerë, shpejtësisë dhe kapacitetit. Projektet të cilat ofrojnë shpejtësi të transmetimit të të dhënave më pak se 30 Mbps duhet të sigurojnë rritjen e shpejtësive në të paktën 30 Mbps dhe kur është e mundur në 100 Mbps e më lart me kalimin e kohës.

3. Vlerësimi i projektit për krijimin e strukturave optimale të financimit:

Zbatimi i veprimeve do të bazohet në një vlerësim gjithëpërfshirës të projektit. Një vlerësim i tillë i projektit do të mbulojnë, ndër të tjera, kushtet e tregut duke përfshirë informacionin mbi infrastrukturën ekzistuese dhe/ose të planifikuar, detyrimet rregullatore ndaj promotorëve të projektit, si dhe strategjitë e tregut dhe të marketingut.

Në veçanti, vlerësimi i projektit do të përcaktojë nëse programi:

a) është i nevojshëm për të adresuar dështimet e tregut ose situatat nënoptimale të investimeve, të cilat nuk mund të zgjidhen nga masat rregullator;

b) nuk çon në shtrembërime të tregut dhe dekurajim të investimeve private.

Këto kritere do të vendosen kryesisht në bazë të potencialit të të ardhurave dhe nivelit të rrezikut të lidhur me projektin dhe llojin e zonës gjeografike që mbulohet nga një veprim.

4. Burimet e financimit

Projektet me interes të përbashkët në fushën e rrjeteve me brez të gjerë në rrjetet transevropiane financohen sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse të BE-së.

SEKSIONI 3. VEPRIMET HORIZONTALE

Vendosja e rrjeteve transevropiane në fushën e infrastrukturës së telekomunikacionit që do të ndihmojë në heqjen e pengesave ekzistuese në Tregun e Vetëm Digjital do të shoqërohen me studime dhe veprime mbështetëse programore. Këto veprimet mund të përbëhen nga njëra prej tyre:

- a) asistencë teknike për të përgatitur ose mbështetur veprimet e zbatimit në vendosjen, qeverisjen dhe adresimin e tyre në problemet ekzistuese ose në zhvillim të implementimit; ose
- b) veprimet për të krijuar kërkesa të reja për infrastrukturën e shërbimit digjital.

Mbështetja e BE-së sipas rregullores CEF do të koordinohet me mbështetjen nga të gjitha burimet e tjera të disponueshme, duke shmangur duplikimin e infrastrukturës ekzistuese dhe parandalimin e zëvendësimit/zhvendosjes të investimeve private.

SEKSIONI 4. LIDHJA PA TEL NË KOMUNITETET LOKALE

Duke marrë parasysh qëllimin specifik për adresimin e nevojave lokale, promovimi i lidhjes lokale pa tel, pa pagesë dhe jodiskriminuese në qendrat/ambiente publike është identifikuar nga BE si një projekt i veçantë me interes të përbashkët në sektorin e telekomunikacionit sipas kuptimit të rregullores së BE-së për CEF-in dhe udhëzimit për rrjetet transevropiane në fushën e infrastrukturave të telekomunikacionit.

Veprimet në kuadër të këtij projekti duhet të synojnë ofrimin e lidhjeve lokale pa tel që është pa pagesë dhe pa kushte diskriminuese në qendrat/zonat publike lokale, duke përfshirë hapësirat të jashtme të aksesueshme për publikun e gjerë dhe që luajnë një rol kryesor në jetën publike të komuniteteve lokale, për t'u kualifikuar për ndihmë financiare. Me qëllim aksesueshmërinë, këto veprime do të ofrojnë akses në shërbime në gjuhën shqipe dhe, për aq sa është e mundur, në gjuhë të tjera zyrtare të institucioneve të BE-së.

Sipas praktikës së BE-së, veprimet e ndërmarra për sigurimin e lidhjeve lokale pa tel janë kualifikuar për financim nëse ato:

1. Zbatohen nga një organ i sektorit publik siç përmendet në paragrafin e dytë, i cili është në gjendje të planifikojë dhe mbikëqyrë instalimin, si dhe të sigurojë të paktën tre vjet financimin e kostove operative, të aksesit lokal me vlerë në hapësirat publike të brendshme ose të jashtme.

2. Ndërtojnë lidhje *broadband* me shpejtësi të lartë siç specifikohet në udhëzim duke mundësuar ofrimin e përvojës së internetit me cilësi të lartë për përdoruesit, që:

a) është pa pagesë dhe pa kushte diskriminuese, i lehtë për t'u aksesuar, i sigurt dhe përdor pajisjet më të fundit dhe më të mira të disponueshme, të afta për të ofruar lidhje me shpejtësi për përdoruesit e saj; dhe

b) mbështet aksesin në shërbimet digjitale inovatore, të tilla si ato të ofruara përmes infrastrukturës së shërbimeve digjitale;

3. Të përdorë identitetin e përbashkët vizual që do të ofrohet nga programi dhe të lidhet me mjetet e tjera të lidhura;

4. Të respektojë parimet e teknologjisë neutrale në nivelin e *backhaul*, përdorimin eficient të fondeve publike dhe aftësinë për të përshtatur projektet me ofertat më të mira teknologjike;

5. Prokurimin e pajisjeve të nevojshme dhe/ose shërbimet e instalimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për të siguruar që projekti nuk shtrembëron konkurrencën; Instalimet nuk duhet të dublikojnë instalimet ekzistuese *wi-fi* falas, qofshin ato private ose publike.

WiFi do të synojë të ofrojë akses falas në internet për banorët vendas dhe vizitorët, në qendrat kryesore të jetës komunitare (parqe, sheshe, biblioteka, ndërtesa publike, spitalet etj.).

Buxheti i disponueshëm do të alokohet në mënyrë të balancuar gjeografike përmes të gjithë vendit duke përmblusur kushtet e vendosura në këtë seksion dhe mbi bazën e numrit të kërkesave të marra duke respektuar parimin e transparencës dhe përfshirë të gjitha propozimet e vlefshme të marra.

Veprimet nuk duhet të dublikojnë ofertat ekzistuese për lidhje lokale falas private ose publike me karakteristika të ngjashme, duke përfshirë dhe ato në të njëjtën hapësirë publike.

Veprimet e financuara sipas këtij seksioni duhet të jenë të monitoruara ngushtësisht për të paktën tre vite. Pas periudhës operationale do të vazhdohet të ofrohet një raport mbi funksionimin e këtyre veprimeve dhe të vlerësohen ndërhyrjet e mundshme për iniciativa në të ardhmen.